REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.1521/1 prot. Lushnje më, 15 /02/2024

PROJEKT VENDIM

Nr.13, Datë 15/02/2024

"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRVENDORE PËR MENAXHIMIN E LANDFILLIT (DEPOZITIM, PESHIM & MIRËMBAJTJE E RRUGËS HYRËSE) NË IMPIANTIN E MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER"

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës ____/____/ 2024, bazuar në relacion e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në nenet 3 gërma "c", 8 pika 1, 9pika 1.1 gërma "a", 14 pika 2, 23 pika 10, 33 gërma "c",të ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane", ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, date 03.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane" dhe kërkesës nr. 3080 prot., datë 22.09.2023 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë, VKB-në Nr 86 datë 27.10.2023 "Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të landfillit të mbetjeve urbane të administruar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë":

PROPOZOJMË

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e Landfillit (depozitim, peshim, pastrim & mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier, bashkangjitur këtij materiali.
2. Efektet financiare do të mbulohen nga fondet e trashëguara.
3. Për ndjekje dhe zbatimin e kësaj marrveshje ngarkohet Ndërmarrja e Pasurisë Publike,Bashkia Lushnje.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

Drejtor NPP
Evis Qyra

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Kryetar i Bashkisë
Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com